



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS / OPŠTINA DJAKOVICA
MUNICIPALITY OF GJAKO



Date: 13.04.2018

KONKURS

Zyra e Kryetarit të komunës së Gjakovës u bën thirrje të gjitha organizatave të shoqërisë civile të fokusuar në problematiken e komuniteteve romë ashkali dhe egjiptian si dhe organizatave ndërkombëtare që punojnë në drejtim të përmirësimit të gjendjes së pjesëtarëve të komuniteteve romë ashklai dhe egjiptian, që të konkurrojnë për të qenë anëtarë i Komitetit Komunal Veprues (KKV) i cili do të themelohet në kuadër të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve romë dhe ashkli në shoqërinë kosovare 2017 – 2021.

Sipas kësaj Strategjie, qëllimi i themelimit të këtyre Komiteteve është :

- Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve romë ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare.
- KKV do të shërbejë si një strukturë mbështetëse lokale për koordinimin e aktiviteteve me Zyrën e Kryeministrit, Zyrat për Qeverisje të mirë etj..

Kriteret për të qenë anëtarë i Komiteti Komunal Veprues:

1. Organizata duhet të zhvillojë programe që kanë për qëllim avancimin e pozitës së pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian;
2. Organizata duhet të zhvillojë aktivitet në komune të Gjakovës;
3. Duhet të jetë organizatë aktive në komune të Gjakovës për të paktën tre (3) vitet e fundit;
4. Duhet të jetë organizatë kredibile dhe profesionale.

Dokumentin e nevojshme për aplikim janë:

- Certifikata e regjistrimit të organizatës;
- Dëshmi për përvojën tre vjeçare dhe dëshmi për punë me komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian.
- C.V e personit të propozuar nga drejtori OJQ-së (aplikues mund të jetë edhe vetë drejtori OJQ-së).

Mandati i përfaqësuesve të organizatës në KKV do të jetë 4 vjeçar.

Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë, duke filluar nga dt.16.04.2018 dhe përfundon më 29.04.2018 deri në ora 16:00.



Kryetari Komunal
Ardian Gjini